



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:007173  
Datë: 22.12.2023  
Numri i dokumentit: 05110623

**C-IV-22-0020**

*Ankuesit*

1. R M
2. Z S
3. Z S
4. G K
5. S S
6. D S
7. L P
8. N M

*Te gjithë përfaqësuar nga V H, avokat nga Prishtina.*

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

**Për: Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 22 dhjetor 2023, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

1. **Kërkesa për Masë të Sigurimit, refuzohet si e pabazuar.**
2. **Nuk caktohen taksa gjyqësore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 31 janar 2022, ankuesit R M, Z S, Z S, G K, S S, D S, L P, N M, nëpërmjet të autorizuarit të tyre parashtruan në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (Dhoma e Posaçme), një ankesë të

përbashkët për pagesën e pagave të fundit të papaguara dhe pagimin e dëmit material për ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënies të punës, tek NSH “Sloga” (në likuidim) si në vijim:

### **Ankuesi 1. R M**

Në ankesën e tij të përbashkët kundër Vendimit nr. PRN.192-0015 të datës 24 dhjetor 2021, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim në emër të aksioneve nga NSH “KB Sloga” (në likuidim), ankuesi pohon se nuk qëndron fare arsyetimi i AKP-së se ai nuk ka sjellë dëshmi se ka punuar në NSH “Sloga” në Fushë Kosovë, andaj një vendim i tillë është i padrejtë dhe kundër dispozitave ligjore në fuqi. Ankuesi më tej pohon se Agjencia edhe pse kërkesën e tij e ka refuzuar kinse nuk ka dëshmi të mjaftueshme, ajo nuk e ka ftuar ankuesin personalisht për ta plotësuar apo kompletuar ankesën në fjalë. Ankuesi më tej pohoi se nëse gjykata nuk gjen elemente për vendosje në çështje meritore, ta kthej çështjen tek AKP në rivendosje. Ankuesi theksoi se AKP konstaton se duke u mbështetur në provat e ankuesit, ai nuk i plotëson të gjitha kriteret ligjore sipas nenit 36.2 të Ligjit 04/L-034 për AKP-në. Më datë 26 nëntor 2021 është pranua vendimi i kundërshtuar prandaj sipas nenit 40.1.6.2 të Ligjit të AKP me këtë dispozitë parashihet që ankuesve ju takon e drejta e kompensimit për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës “*nëse janë pushuar nga puna si rrjedhojë e veprimeve të AKP-së sipas nenit 66.1 apo 66.2*”. Nga ky vendim thuhet se ankuesit ju ka ndërprerë marrëdhënia e punës në vitin 1998, ndërsa punëtorët kanë punuar deri në maj 1999. Ankuesi më tej thekson se AKP parasheh që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe se pas përgjigjes së AKP-së ankuesi nuk parashtrij përgjigje dhe se e paditura pohon se nuk ka pas diskriminim.

### **Ankuesja 2. Z S**

Në ankesën e saj të përbashkët kundër Vendimit nr. PRN192-0003, të datës 24 dhjetor 2021, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e saj për kompensim në emër të aksioneve nga NSH “KB Sloga” (në likuidim), pohon se nuk qëndron fare arsyetimi i AKP-së se ai nuk ka sjellë dëshmi se ka punuar në NSH “Sloga” në Fushë Kosovë, andaj një vendim i tillë është i padrejtë dhe kundër dispozitave ligjore në fuqi. Ankuesja më tej pohon se Agjencia edhe pse kërkesën e saj e ka refuzuar kinse nuk ka dëshmi të mjaftueshme, ajo nuk e ka ftuar ankuesen personalisht për ta plotësuar apo kompletuar ankesën në fjalë. Ankuesja më tej pohoi se nëse gjykata nuk gjen elemente për vendosje në çështje meritore, ta kthej çështjen tek AKP në rivendosje. Ankuesja theksoi se AKP konstaton se duke u mbështetur në provat e ankueses, ajo nuk i plotëson të gjitha kriteret ligjore sipas nenit 36.2 të Ligjit 04/L-034 për AKP-në. Më datë 27 nëntor 2020 AKP i dërgon shkresë ankueses për plotësim të informatave. Ankuesja theksoi se AKP përgjigjet se duke u bazuar në provat e ankueses konstaton se ajo nuk i plotëson të gjitha kriteret ligjore sipas nenit 36.2 të Ligjit 04/L-034 për AKP-në. Ankuesja më tej thekson

se AKP parasheh që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe se pas përgjigjes së AKP-së ankuesja nuk parashtroj përgjigje dhe se e paditura pohon se nuk ka pas diskriminim.

### **Ankuesi 3. Z S**

Në ankesën e tij të përbashkët kundër Vendimeve nr. PRN192-0010 dhe PRN192-0012 që të dyja të datës 24 dhjetor 2021, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilët ishin refuzuar si të pavlefshme kërkesat e tij për kompensim për paga të papaguara dhe kompensim në emër të aksioneve, nga NSH “KB Sloga” (në likuidim), pohoi se nuk qëndron fare arsyetimi i AKP-së se ai nuk ka sjellë dëshmi se ka punuar në NSH “KB Sloga” në Fushë Kosovë, andaj një vendim i tillë është i padrejtë dhe kundër dispozitave ligjore në fuqi. Ankuesi më tej pohon se Agjencia edhe pse kërkesën e tij e ka refuzuar kinse nuk ka dëshmi të mjaftueshme, ajo nuk e ka ftuar ankuesin personalisht për ta plotësuar apo kompletuar ankesën në fjalë. Ankuesi më tej pohoi se nëse gjykata nuk gjen elemente për vendosje në çështje meritore, ta kthej çështjen tek AKP në rivendosje. Me 27 nëntor 2020 AKP i dërgon shkresë ankuesit për plotësime shtesë dhe se ankuesi thekson se AKP konstaton se duke u mbështetur në provat e ankuesit, ai nuk i plotëson të gjitha kriteret ligjore sipas nenit 36.2 të Ligjit 04/L-034 për AKP-në. Ankuesi më tej thekson se AKP parasheh që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe se pas përgjigjes së AKP-së ankuesi nuk parashtroj përgjigje dhe se e paditura pohon se nuk ka pas diskriminim.

### **Ankuesja 4. G S**

Në ankesën e saj të përbashkët kundër Vendimit nr. PRN192-0021, të datës 24 dhjetor 2021, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e saj për kompensim në emër të aksioneve nga NSH “KB Sloga” (në likuidim), pohon se nuk qëndron fare arsyetimi i AKP-së se ai nuk ka sjellë dëshmi se ka punuar në NSH “Sloga” në Fushë Kosovë, andaj një vendim i tillë është i padrejtë dhe kundër dispozitave ligjore në fuqi. Ankuesja më tej pohon se Agjencia edhe pse kërkesën e saj e ka refuzuar kinse nuk ka dëshmi të mjaftueshme, ajo nuk e ka ftuar ankuesen personalisht për ta plotësuar apo kompletuar ankesën në fjalë. Ankuesja më tej pohoi se nëse gjykata nuk gjen elemente për vendosje në çështje meritore, ta kthej çështjen tek AKP në rivendosje. Ankuesja theksoi se AKP konstaton se duke u mbështetur në provat e ankueses, ajo nuk i plotëson të gjitha kriteret ligjore sipas nenit 36.2 të Ligjit 04/L-034 për AKP-në. Me datë 27 nëntor 2020 AKP i dërgon shkresë ankueses për plotësim të informatave. Ankuesja theksoi se AKP përgjigjet se duke u bazuar në provat e ankueses konstaton se ajo nuk i plotëson të gjitha kriteret ligjore sipas nenit 36.2 të Ligjit 04/L-034 për AKP-në. Ankuesja më tej thekson se AKP parasheh që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe se pas përgjigjes së AKP-së ankuesja nuk parashtroj përgjigje dhe se e paditura pohon se nuk ka pas diskriminim.

## **Ankuesja 5. S S**

Në ankesën e saj të përbashkët kundër Vendimit nr. PRN192-0024, të datës 24 dhjetor 2021, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e saj për kompensim në emër të aksioneve nga NSH “KB Sloga” (në likuidim), pohon se nuk qëndron fare arsyetimi i AKP-së se ai nuk ka sjellë dëshmi se ka punuar në NSH “Sloga” në Fushë Kosovë, andaj një vendim i tillë është i padrejtë dhe kundër dispozitave ligjore në fuqi. Ankuesja më tej pohon se Agjencia edhe pse kërkesën e saj e ka refuzuar kinse nuk ka dëshmi të mjaftueshme, ajo nuk e ka ftuar ankuesen personalisht për ta plotësuar apo kompletuar ankesën në fjalë. Ankuesja më tej pohoi se nëse gjykata nuk gjen elemente për vendosje në çështje meritore, ta kthej çështjen tek AKP në rivendosje. Ankuesja theksoi se AKP konstaton se duke u mbështetur në provat e ankueses, ajo nuk i plotëson të gjitha kriteret ligjore sipas nenit 36.2 të Ligjit 04/L-034 për AKP-në. Më datë 27 nëntor 2020 AKP i dërgon shkresë ankueses për plotësim të informatave. Ankuesja theksoi se AKP përgjigjet se duke u bazuar në provat e ankueses konstaton se ajo nuk i plotëson të gjitha kriteret ligjore sipas nenit 36.2 të Ligjit 04/L-034 për AKP-në. Ankuesja më tej thekson se AKP parasheh që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe se pas përgjigjes së AKP-së ankuesja nuk parashtroj përgjigje dhe se e paditura pohon se nuk ka pas diskriminim.

## **Ankuesi 6. D S**

Në ankesën e tij të përbashkët kundër Vendimit nr. PRN192-0006 datë 24 dhjetor 2021, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim në emër të aksioneve nga NSH “KB Sloga” (në likuidim), pohon se nuk qëndron fare arsyetimi i AKP-së se ai nuk ka sjellë dëshmi se ka punuar në NSH “Sloga” në Fushë Kosovë, andaj një vendim i tillë është i padrejtë dhe kundër dispozitave ligjore në fuqi. Ankuesi më tej pohon se Agjencia edhe pse kërkesën e tij e ka refuzuar kinse nuk ka dëshmi të mjaftueshme, ajo nuk e ka ftuar ankuesin personalisht për ta plotësuar apo kompletuar ankesën në fjalë. Ankuesi më tej pohoi se nëse gjykata nuk gjen elemente për vendosje në çështje meritore, ta kthej çështjen tek AKP në rivendosje. Me datë 27 nëntor 2020 AKP i dërgon shkresë ankuesit për plotësim shtesë dhe se ankuesi thekson se AKP konstaton se duke u mbështetur në provat e ankuesit, ai nuk i plotëson të gjitha kriteret ligjore sipas nenit 36.2 të Ligjit 04/L-034 për AKP-në. Ankuesi më tej thekson se AKP parasheh që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe se pas përgjigjes së AKP-së ankuesi nuk parashtroj përgjigje dhe se e paditura pohon se nuk ka pas diskriminim.

## **Ankuesi 7. L P**

Në ankesën e tij të përbashkët kundër Vendimit nr. PRN192-0009 datë 24 dhjetor 2021, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim në emër të aksioneve nga NSH “KB Sloga” (në likuidim), pohon se nuk qëndron fare arsyetimi i AKP-së

se ai nuk ka sjellë dëshmi se ka punuar në NSH “Sloga” në Fushë Kosovë, andaj një vendim i tillë është i padrejtë dhe kundër dispozitave ligjore në fuqi. Ankuesi më tej pohon se Agjencia edhe pse kërkesën e tij e ka refuzuar kinse nuk ka dëshmi të mjaftueshme, ajo nuk e ka ftuar ankuesin personalisht për ta plotësuar apo kompletuar ankesën në fjalë. Ankuesi më tej pohoi se nëse gjykata nuk gjen elemente për vendosje në çështje meritore, ta kthej çështjen tek AKP në rivendosje. Me datë 27 nëntor 2020 AKP i dërgon shkresë ankuesit për plotësime shtesë dhe se ankuesi thekson se AKP konstaton se duke u mbështetur në provat e ankuesit, ai nuk i plotëson të gjitha kriteret ligjore sipas nenit 36.2 të Ligjit 04/L-034 për AKP-në. Ankuesi më tej thekson se AKP parasheh që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe se pas përgjigjes së AKP-së ankuesi nuk parashtroj përgjigje dhe se e paditura pohon se nuk ka pas diskriminim.

### **Ankuesi 8. N M**

Në ankesën e tij të përbashkët kundër Vendimeve nr. PRN192-0017 datë 24 dhjetor 2021, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 5,000.00 € dhe PRN192-0016 më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për tre paga të fundit të papaguara në shumë prej 2,000.00 €, si dhe PRN192-0018 më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim në emër të aksioneve, që të gjitha këto nga NSH “KB Sloga” (në likuidim). Ankuesi pohon se nuk qëndron fare arsyetimi i AKP-së se ai nuk ka sjellë dëshmi se ka punuar në NSH “Sloga” në Fushë Kosovë, andaj një vendim i tillë është i padrejtë dhe kundër dispozitave ligjore në fuqi. Ankuesi më tej pohon se Agjencia edhe pse kërkesën e tij e ka refuzuar kinse nuk ka dëshmi të mjaftueshme, ajo nuk e ka ftuar ankuesin personalisht për ta plotësuar apo kompletuar ankesën në fjalë. Ankuesi më tej pohoi se nëse gjykata nuk gjen elemente për vendosje në çështje meritore, ta kthej çështjen tek AKP në rivendosje. Me datë 26 nëntor 2020 AKP i dërgon shkresë ankuesit ku thotë se sipas Nenit 40.1 par.6 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në Nr.04/L-034 kjo dispozitë i thekson tre pagat e fundit. Kurse e njëjta shtojcë e Ligjit në fjalë Neni 40.1.6.2 e përcakton kompensimin për ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënies së punës. Ankuesi më tej thekson se sipas AKP duke u mbështetur në provat e tij, ai nuk i plotëson të gjitha kriteret ligjore sipas Nenit 36.2 të Ligjit 04/L-034 për AKP-në. Sipas së paditurës ajo parasheh që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe pas përgjigjes së saj ankuesi nuk parashtroj përgjigje si dhe e paditura pohon se nuk ka pasur diskriminim.

Përfaqësuesi i ankuesve në mbështetje të ankesës së tyre të përbashkët ka dorëzuar dëshmitë në kopje si në vijim: Formën e dorëzimit-pranimit të vulës së rrumbullakët të ndërmarrjes tek AKP nga L P datë 16 qershor 2020 dhe dëshmitë tjera për secilin ankues si: vendimin e kundërshtuar, parashtrësë (njoftim) për përfaqësim nga përfaqësuesi, autorizimin e përgjithshëm, librezën e punës, letërnjoftimin, kërkesë për informata shtesë lëshuar nga AKP, drejtuar secilit ankues, Parashtrësë drejtuar AL të AKP nga drejtori i ndërmarrjes datë 18 maj 2020 dhe dëshmi të tjera të marrëdhënies së punës me NSH (aktvendime) për ankuesit 2, 4, 5 dhe 7, një dëshmi tjetër në dorëshkrim që i referohet shumës 5,843.00 (në gjuhën serbe, e palexueshme).

Me 06 shtator 2023, përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve, avokat V H dorëzoi në gjykatë një propozim për masë të përkohshme të sigurisë lidhur me ndalesën dhe shitjen e pasurisë së patundshmërisë. Neni 297 paragrafi 1 Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe në qoftëse ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos më tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit. Nëse ekziston rreziku se pa caktimin e masës së propozuar, pala kundërshtare do të gjendet në situatë të tillë që do ta pamundësoj, vështirësoj dukshëm realizimin e kërkesës së propozuesit të masës siç do të jetë tjetërsimi i pasurisë tek tjetri. Andaj gjykatës i propozojmë që të merr aktvendim dhe të caktoj masën e përkohshme të sigurimit dhe të ndalohet që kjo paluajtshmëri e cila evidentohet në bazë të certifikatës datë 27 shtator 2018, pronë e cila është në posedim nga AKP që gjendet në Fushë Kosovë, që e njëjta pasuri mos të shitet apo mos të tjetërsohet dhe ti mundësohet propozuesve realizimi i të drejtës subjektive duke e aprovuar kërkesën për masë të përkohshme të sigurisë dhe të obligohet AKP që të veprojnë në bazë të Nenit 8.4 të Rregullores nr.4/2020 për politikën dhe procedurat e likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore. Përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve në mbështetje të masës së përkohshme të sigurimit ka bashkangjitur në kopje dëshmitë si: Autorizimin gjeneral të ankuesve, Vendimin për fillimin e likuidimit dhe emërimin e anëtarëve të AL datë 03 mars 2020, Lista e ndryshimeve për vitet 1989-1996 lëshuar nga Kadastrë- Komuna Fushë Kosovë datë 23 shkurt 2023 që mban vulën e Republikës së Serbisë, Parcela me nr. ..P.SH. KBI. “Kosova Export” Fushë Kosovë, dhe Aktvendimin N.46-31/88-01 datë 26 janar 1989, Parashtrësën datë 21 shkurt 2023 në emër të të gjithë punëtorëve të NSH-së që të parashtrojnë kërkesën Agjencisë Kadastrale në Fushë Kosovë për ndërrimin e destinacionit të gjithë pronës që gjendet në njësinë kadastrale në Fushë Kosovë, gjegjësisht pronën e cila gjendet në pronësi të kësaj ndërmarrje, Përgjigjen e AKP datë 26 prill 2023 në lidhje me parashtrësën e datë 21 shkurt 2023, Kërkesën datë 30 maj 2023 lidhur me qasjet në dokumentet zyrtare sa i përket OSH “Slloga” si dhe shqetësimet e punëtorëve, Përgjigjen e AKP datë 21 korrik 2023 në lidhje me parashtrësën datë 30 maj 2023 ku dorëzoi Certifikatën Kadastrale lëshuar nga Komuna Fushë Kosovë P.SH. K.B Slloga lëshuar më datë 27 shtator 2018.

Me 25 tetor 2023 gjykata lëshoi një urdhër për përfaqësuesin e ankuesve përmes së cilit kërkoi që ndër të tjera të sqaroj se cili do të jetë dëmi i menjëhershëm dhe i pariparueshëm si dhe të bëj pagesën e taksës gjyqësore.

Me 16 nëntor 2023 përfaqësuesi i autorizuar dorëzoi në gjykatë përgjigjen e urdhrin datë 25 tetor 2023 ku thekson se dëmi i pariparueshëm do të jetë nëse gjykata nuk do ta aprovon propozimin për masë të përkohshme të sigurisë dhe se në provat që i kemi ofruar gjykatës ekzistojnë dokumente se prona e OP “Slloga” është pronë me destinacion ndërtimor e kurrsesi tokë bujqësore.

Me 30 nëntor 2023 e paditura, parashtrori përgjigje ndaj propozimit për caktimin e masës së sigurisë, përmes së cilës i kundërshton në tërësi propozimin për caktimin e masës së sigurisë sikur të padrejtë dhe të pabazuar në ligj. Pala kundërshtare/Kundërshtari i sigurimit thekson së asnjë nga kushtet ligjore për marrjen e masës së përkohshme sipas Nenit 61 të Ligjit 06/L-086 nuk është plotësuar. Propozuesit e sigurimit kanë kërkuar që me caktimin e Masës së Sigurisë të caktohet masa e përkohshme e sigurimit dhe të ndalohej që kjo paluajtshmëri e cila evidentohet në bazë të certifikatës datë 27 shtator 2018, pronë e cila është në posedim nga AKP-ja që gjendet në Fushë Kosovë, që e njëjta pasuri mos të shitet apo mos të tjetërsohet dhe ti mundësohet propozuesve realizimi i të drejtës subjektive duke e aprovuar kërkesën për masë të përkohshme të sigurisë, të detyrohet AKP-ja të veproj në bazë të Nenit 8.4 të Rregullores nr.4/2020 për politikën dhe procedurat e likuidimit të NSH, AL-ja ka për obligim të kujdeset dhe për çështjet kadastrale të pronës dhe të rregulloj statusin me Agjencinë Kadastrale në Fushë Kosovë, për pronë e cila ishte në OSH “Sllloga” dhe e njëjta pronë të regjistrohet në pronë ndërtimore. Neni 61 par.1 i Ligjit për Dhomën e Posaçme përcakton se: *“Pas parashtrimit të propozimit nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëmi të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Propozimi për caktimin e Masës së Sigurimit duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë/padie, atëherë ajo duhet të referohet asaj kërkesë/padie”*. Bazuar në këtë nen për tu caktuar Masa e Sigurimit në bazë të kërkesës së propozuesit duhet të përmbushen dy elemente në mënyrë kumulative sikur që janë: *Ekzistimi i kërkesës apo i së drejtës subjektive të tij dhe shkaktimi i dëmit të menjëhershëm dhe të pariparueshëm*. Propozuesit për caktimin e masës së sigurimit nuk e kanë bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive. Propozuesit e Masës së Sigurimit nuk kanë dëshmuar përpara gjykatës se kanë bërë të besueshme kërkesën por gjithashtu as nuk kanë treguar dhe nuk kanë argumentuar se çfarë dëmi do të përfytyrojnë propozuesit në rast të mos caktimit të Masës së Sigurimit. Andaj, e paditura i propozon gjykatës që të refuzoj si të pabazuar propozimin për Masë të Përkohshme të parashtruar nga parashtruesit.

Për detaje tjera referimi mund të bëhet tek dosja e lëndës.

### **Arsyetimi Ligjor**

Kërkesa për masë të sigurimit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.1. të Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (më tej: Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji si *lex specialis* në krahasim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Sipas Nenit 61 të Ligji për Dhomën e Posaçme, Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme se do të ketë dëmi të

menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i pariparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Paditësi i cili kërkon masë të sigurimit duhet të dorëzoj dëshmi të besueshme se:

1. ekziston e drejta, dhe
2. kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë të pariparueshme nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Barra e provës është tek propozuesi i masës së sigurimit, kështu që i njëjti përveç që duhet të ofroj dëshmi të besueshme se e drejta e rrezikuar ekziston, duhet të ofrojë dëshmi dhe ta bëjë të besueshëm faktin se do të shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, nëse nuk aprovohet kërkesa për masë të sigurimit.

Në këtë aspekt pa paragjykuar zgjidhjen përfundimtare të këtij kontesti, gjykata konstaton se nuk janë plotësuar kushtet e dispozitës së nenit 61 për caktimin e masës së sigurimit, pasi që në këtë fazë të procedurës propozuesi nuk ka ofruar dëshmi të besueshme se ekziston e drejta e pretenduar. Paditësi duhet që të dorëzoj dëshmi të besueshme se kjo e drejtë mund të dëmtohet menjëherë dhe në mënyrë të pariparueshme, nëse nuk miratohet kërkesa për masë të sigurimit.

Gjykata ka shqyrtuar kërkesën e përfaqësuesit të ankuesve për lëshimin e masës së sigurimit mirëpo nuk ka gjetur bazë për aprovimin e saj, kjo pasi dëshmitë e dorëzuara nuk mbështesin një propozim të tillë. Duke u nisur nga propozimi dhe dëshmitë e dorëzuara nga përfaqësuesi i ankuesve, e të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata gjen se edhe pas urdhrit të saj të datës 25 tetor 2023 për të sqaruar se cili do të jetë dëmi i menjëhershëm dhe i pariparueshëm në rast mos aprovimi të kërkesës për masë të sigurimit, kërkesa e tyre mbeti e pambështetur në dëshmi të besueshme se e drejta e tyre mund të dëmtohet nëse nuk miratohet kërkesa e tyre për masë të sigurisë. Për më tepër, kërkesa e përfaqësuesit të ankuesve për caktimin e masës së sigurisë edhe pas urdhrit të gjykatës mbetet kontradiktore. Në rastin konkret kemi një ankesë kolektive kundër vendimeve të AL me të cilat vendime ishin refuzuar kërkesat e ankuesve për kompensim dëmi në emër të aksioneve dhe kërkesa të tjera nga marrëdhënia e punës në NSH, për çka ekziston një procedurë e veçantë e shqyrtimit (të kërkesave kreditore) gjatë likuidimit të NSH, e të cilat procedura udhëhiqen nga Agjencia apo AL-të përkatëse, siç edhe ka ndodhur në këtë rast. Prandaj, fakti se ekziston një ankesë kolektive në lidhje me vendimet e kundërshtuara në fjalë për shqyrtim në këtë gjykatë, një situatë e tillë nuk mund të shërbej si bazë për të vendosur masë të sigurimit, e cila do të mund të pengonte procesin e likuidimit të NSH-së apo shitjen / tjetërsimin e paluajtshmërive apo asetëve të tjera të NSH-së.

Pretendimet tjera të ankuesve në lidhje me këtë çështje përtej pretendimeve që kanë të bëjnë me kërkesën për masë të sigurimit, nuk do të shqyrtohen në këtë fazë të procedurës.



Nga sa u tha më lartë gjykata nuk ka gjetur se kërkesa e paditësit për Masë të Sigurimit mund të ketë mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, prandaj kërkesa si e tillë u refuzua.

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Përfaqësuesi i ankuesve e ka paguar taksën gjyqësore për kërkesën për masë të sigurimit në shumë prej 100.00 € dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli  
Gjyqtar